REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

Drejtoria e Arsimit *11.08.2025* *Nr.07-Zyrtarisht*

Në bazë Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016, neni 11 dhe kërkesave të SHML-së dhe IAAP- së , Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan shpallë këtë:

FTESË PËR OFERTË

Për organizimin e Ekskursioni në Shqipëri, më maturantë të dy shkollave të mesme të larta:

1. SHML- Gjimnazi - ''Vëllezërit Frashëri'' në Deçan;
2. IAAP - ''Tafil Kasumaj'' në Deçan.
3.

Ekskursioni do të jetë 5 ditë kalendarike (katër bujtje).

Agjensioni duhet të plotësojë këto parakushte:

1. Të ketë licencë valide;
2. Të ketë kontroll teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore;
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve;
4. Autobusët të jenë komfor dhe më klimë;
5. Të mos ketë referenca negative;
6. Të ofrojë dëshmi për shëndetin fizikë dhe mendor të ngasësve të autobusëve, kontrolle valide
7. Të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune si dhe diplomë të mjekut të angazhuar);
8. Agjensioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e caktuar të ekskursionit;
9. Të posedojë dokumentacionin (licencë), e agjensionit të akreditimit të ushqimeve për vendqëndrimin e nxënësve,
10. T'i mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasave, përfaqësuesit të DKA-së(Monitorues), përfaqësuesit të Këshillit të Prindërve(Monitorues) dhe shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike:
11. Ekskursioni do të zhvillohet në shtetin shqiptar, pikë qëndrimi do të jetë Durrësi(Rekomandohet Hotel Bonita)
12. **Do të ofrohen tre shujta ditore (mëngjes, drekë dhe darkë);**
13. **Do të vizitohen këto qendra: Shkodra, Lezha, Tirana, Kruja, dhe Berati – (Gjimnazi);**
14. **Do të vizitohen këto qendra: Kruja, Durrësi, Vlora, Tirana, Lezha. – (IAAP).**

Ofertuesi ka për obligim të përcaktojë se për cilën shkollë oferton.
Oferta do të shqyrtohen për secilën shkollë në mënyrë të veçantë, pa u ndikuar nga ofertat e shkollave tjera, objekte të kësaj oferte.
Kriteret për përzgjedhjen e kompanisë janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016.
Kompanitë fituese, do të monitorohen nga DKA-ja , si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Afati i ofertës është 7 ditë, nga dita e shpalljes.

Ofertat protokollohet në zyrën pritëse, dhe dorëzohen në zarfe të mbyllura (personalisht), në zyrën e DKA-së në katin e parë.
Data e fundit e dorëzimit të ofertave behet me dt.18.08.2025, ora 16:00

Hapja e ofertave bëhet më datë 18.08.2025, në Sallën e Asamblesë Komunale në Deçan, duke filluar nga ora 16:00, në prani të përfaqësuesve të SHML- IAAP, si dhe përfaqësuesve të agjensioneve turistike,

Veretje: Agjensioni Turistik, do të njoftohet zyrtarisht me dt.19.08.2025, nëse ka plotësuar kushtet dhe kriteret e ofertës, sipas: Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016, neni 11, pika 2.14.

Drejtori i DKA

Z. Besnik Hulaj

Org. Arsimit 21953
07 11.08.25